



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 158/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hajriz Hoti kryesues, Ramush Bardiqi dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovica e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 25.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hudhen të palejuara ankesat e parashtruara nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë A.nr.158/2021 dhe Anr.159/2025, të datës 23.01.2025, paraqitur kundër Subjektit Politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovica e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat A.nr.158/2021 dhe Anr.159/2025, të parashtruara nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë në të cilën pretendohet se Subjekti Politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicën e Veriut, në të cilat pretendohet se më datë 23 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje, në Mitrovicën e Veriut ka identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të kandidatit për deputet të partisë Srpska Demokratija, Aleksandër Arsenijevic, në ndërtesat publike në rrugën “Kneza Milosa”, në Mitrovicën e Veriut.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik Srpska Demokratija kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe*

vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”

Si provë parashtruesi i ankesave ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.158/2025 dhe A.nr.159/2025, të paraqitura me datë 23.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.158/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesat e parashtruara nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kanë njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje-LVV, Anr.160/2025 të paraqitur me datën 23.01.2025, kundër Subjektit Politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicën e Veriut, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 160/2025 të datës 25.01.2025 me të cilin Subjektit Politik Srpska Demokratija i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 3,500.00(tremijë e pesëqind) euro.

Megjenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.160/2025 të datës 25.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të çështjeve të theksuara në ankesa.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 158/2025 më datën 25.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.